



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK DIVJAKË

Nr. 6735 / Prot. 20

Divjakë më 18 / 07 / 2025

Lënda:

THIRRJE

“PËR ZHVILLIMIN E MBLEDHJES SË RADHËS TË KËSHILLIT BASHKIAK  
DIVJAKË, MUAJI KORRIK 2025 ”

ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK

Për dijëni: **KRYETARIT TË BASHKISË DIVJAKË  
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, neni 56, pika 2, gërma ( a ) të Ligjit nr 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Divjakë, miratuar me VKB, nr 28 datë 13.04.2020, ndryshuar me V.K.B. Nr.48 datë 25.09.2023, neni 56, Ju njoftojmë se: Më datë: 25 .07. 2025, ditën e Premte ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve, pranë Shtëpisë së Kulturës Divjakë, në katin e dytë, thirret “Mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Korrik 2025”. **Me këtë**

**Rend dite:**

1.Miratim i Rendit të Ditës.

**2.Projekt-vendim:** Për miratimin e mbarimit përpara afatit të mandatit të këshilltares znj. Ana Nako, e Subjektit Politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

**3.Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Bashkiak Divjakë.**

- Propozimi i kandidatëve për Kryetar të Këshillit. - Përgatitja dhe procedurat e votimit; - Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e Kryetarit të Këshillit Bashkiak;

4.Miratim i Proçesverbalit të mbledhjes që u zhvillua më datë 25.06.2025

5.Informacion mbi zbatimin e Vendimeve të Këshillit Bashkiak Divjakë për muajin Qershor 2025

**6.Projekt-vendim:** Për miratimin e familjeve që do të trajtohen nga fondi i kushtëzuar deri 6% për muajin Qershor 2025.

**7.Projekt-vendim:** Për shtimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në buxhetin e Bashkisë Divjakë për vitin 2025 nga financimet e huaja, si dhe miratimin e një rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2025.

**8.Projekt-vendim:** Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare z. Vladimir Zhuka, për rehabilitimin e dëmeve të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesë. Qyteti Divjakë.

**9.Projekt-vendim:** Për miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve për programin buxhetor afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Divjakë.

**10.Projekt-vendim:** Për miratimin e Aktmarrëveshjes për projektin “Ndërtim Trotuari, kryqëzimi Çermë Sektor dhe rehabilitimi me ndriçues”

**11.Projekt-vendim:** Për miratimin në parim të projektit “Linja e kanalizimit të ujrave të zeza dhe shtesa e impiantit, Bashkia Divjakë.”

**12.Projekt-vendim:** Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.70 datë 24.12.2024” Për miratimin e niveleve të pagave të Bashkisë Divjakë, Njësive Administrative dhe institucioneve në vartësi për vitin 2025, i ndryshuar.

**13. Projekt-vendim:** Për një ndryshim në VKB Nr. 73 datë 30.12.2024” Për miratimin e një shtese fondi dhe shpërndarje në buxhetin e vitit 2024, për rivitalizimin e tregjeve tradicional për Bashkinë Divjakë”

**Mbledhja e Komisioneve:** - Për pikat **Nr.6,7,8,9,10, 12**, Komisioni i Ekonomisë dhe i Financave.

-Për pikën Nr.11,13, Komisioni i Urbanistikës.

**Duke ju falenderuar !**

ZV/KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Liri Biti

